



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1687 prot.

Tiranë, më 13.10.2025

VENDIM

Nr. 11, Datë 13/10/2025

PËR

MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR VOTUESIT

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, si dhe të Urdhrit të Rektorit nr. 107, datë 01.09.2025 “Për marrjen e masave për zhvillimin e procesit zgjedhor, caktimin e datës së fillimit të procesit zgjedhor dhe të datës së zhvillimit të zgjedhjeve për përgjegjës të njësive bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë në Universitetin e Arteve”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UART,

VENDOSI:

1. Zgjedhjet për Njësinë Bazë Kanto dhe Njësinë Bazë Skulpturë mbahen ditën e mërkurë, më datë 15 Tetor 2025.
2. Qendrat e votimit, ku do të zhvillohet procesi zgjedhor ditën e zgjedhjeve, janë:
 - Salla “Ibrahim Madhi”, për Fakultetin e Muzikës;
 - Lektoriumi nr. 2, për Fakultetin e Arteve të Bukura.
3. Të gjithë votuesit duhet të jenë të pajisur me mjet identifikimi (kartë ID apo pasaportë biometrike).
4. Qendrat e votimit do të qëndrojnë të hapura nga ora 08:00 deri në orën 16:00. Qendra e votimit mbyllet më parë nëse konstatohet që ka votuar e gjithë trupa zgjedhore.
5. Vetëm shenjat “x”, “+” dhe “√” janë të vlefshme në votim dhe duhet të jenë të vendosura brenda kutisë përkatëse.
6. Fletët e votimit, para se të hidhen në kutinë përkatëse, palosen në mënyrë të tillë që vulat e KIZ-it dhe KZF-ve përkatëse të jenë të dukshme.

7. Ndaloheh rreptësisht prishja e qetësisë, filmimi dhe bërja e fotografive gjatë procesit të votimit dhe të numërimit nga votuesit, vëzhguesit, kandidatët dhe përfaqësuesit e tyre si vëzhgues.
8. Në ambientet e njësive kryesore, ku kryhet procesi i votimit, ndaloheh rreptësisht çdolloj forme fushate zgjedhore për kandidatët konkurrentë.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzuesi KZF-të e Fakultetit të Muzikës dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura.
10. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Orges Malaj

Kryetar



Shpëtim Kërçova

Anëtar

Redjan Mulla

Sekretar

Suela Agolli

Anëtar

Adela Kusuri

Anëtar

Sara Caca

Anëtar